



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 92

Prishtinë, më 29.10.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Munguan : Liburn Aliu, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 22.10.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Regjistrimin e Bujqësisë,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, ndërkaq u sugjeruan edhe disa nënpika për pikën të ndryshme.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.10.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.10.2012.

Shqyrtimi i Projektligjit për Regjistrimin e Bujqësisë

Kryetari i Komisionit sugjeroi që Komisioni të shqyrtoi Amendamentet e sugjeruara në bashkëpunim me Ekspertët dhe u miratuan si vijon :

Amendament 1

Neni 2, Paragrafi 1, në rreshtin e 2 pas “bujqësorë” shtohet “**dhe**”.

Amendament 2

Neni 3

Në tërë tekstin e Nenit, në fillim të çdo përkufizimi hiqet fjala “është”.

Fjala “Terminet” të zëvendësohet me “Shprehjet”.

Në pikën 1.1 në fund pas “familjare” fjala “**e cila**” fshihet.

Në pikën 1.2 hiqet fjala “**dhe në llogari**”.

Në pikën 1.6 fshihet fjala “**frutave të malit**”.

Amendament 3

Neni 6

Paragrafi 3.1 fjala e parë “pronarin” zëvendësohet me “**titullarin**”.

Paragrafi 3.2, pas fjalës “mosha” shtohet “**edukimi**”.

Paragrafi 6, në fund hiqet “dhe”.

Amendament 4

Neni 10, fjala “organet e” zëvendësohet me “**institucionet përkatëse të**”.

Amendament 5

Neni 13, paragrafi 1, fjala “shpërndajë”, zëvendësohet me fjalën “**shpallë**”. Në paragrafin 1, në fund shkurtesa “e” del në fillim të nënparagrafit 1.1. Tek nënparagrafi 1.2 fjala “shpërndahen” zëvendësohet me fjalën “**të regjistrimit**”.

Amendament 6

Neni 14, Paragrafi 1, fshihet fjala “organi” dhe mbetet fjala “**trupi**”.

Amendament 7

Neni 15

Paragrafi 1.3 fjala “draftet e pyetësorëve” zëvendësohet me “**projekt pyetësorët**”.

Paragrafi 1.7, fjala “pëlqimin” zëvendësohet me “**mendimin**”.

Paragrafi 1.9, pas fjalës “rezultateve” fjala “raportuar” zëvendësohet me fjalën “**të raportuara**”.

Paragrafi 2, viti 2013 zëvendësohet me **2014**.

Amendament 8

Neni 16, në titullin e Kreut fjala “DREJTA” bëhet “**DREJTAT**”.

Amendament 9

Neni 19, në titullin e Kreut fjala “FUSHAT” bëhet “**FUSHATA**”.

Amendament 10

Neni 21, Paragrafi 1.2, në fund shtohet “**dhe njësive tjera juridike bujqësore**”.

Amendament 11

Neni 22, riformulohet Paragrafi 3 :

3. “**Fondet e mbledhura nga donatorët, duhet të specifikohen me anë të marrëveshjeve të veçanta**”.

Amendament 12

Neni 24

Në 6 pikat e Nenit, pas fjalës “dënohet” shtohet fjala “**për Kundërvajtje**”, ndërkah në pikat... ku ceket “Neni 5” duhet të jetë “**Neni 6 dhe Neni 9**”.

Vërejtje : Të harmonizohet versioni anglisht me versionin shqip.

4. Të ndryshme

Në çështjet e miratuara si nënpika shtesë në fillim të mbledhjes, u diskutuan dhe u vendosën si vijon :

- Projektligji për Komplekset memoriale duhet të shqyrtohet më detalisht dhe të shikohet mundësia e ekspertizës, pasi që të dërgoi MMPH zyrtarisht shkresën e kërkuar nga ky Komision. **Daut Haradinaj** arsyetoi kërkesën për detalizime duke pas parasysh se këto komplekse duhet të përfshijnë jo vetëm luftën e fundit por edhe më heret (ceku disa emra dhe ngjarje : Jusuf Gërvalla, Haxhi Zeka, demonstratat e viteve 1981, 1991 etj). Gjithashtu edhe **Nijazi Idrizi** dhe **Salih Morina** cekën disa arsye pse duhet të shqyrtohet me kujdes ky projekt.
- Përkundër sqarimeve të Kryetarit të Komisionit rreth dilemave të paraqitura, për Projektligjin e Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna u konstatua se ky Komision në mënyrë unike ka përfunduar shqyrtimin, mirëpo për shkak të ndarjeve që janë krijuar në Komisionin për Buxhet rreth implikimeve financiare dhe ndarjeve e mosmarrëveshjeve në mes dy Ministrive (MB dhe MMPH), është e nevojshme të diskutohen këto dy Projektligje edhe në Grupet Parlamentare. Komisioni në mbledhjen e radhës do të vendos për procedimin e tyre në mbledhjen plenare,
- Projektligji për ujërat do të shqyrtohet të mërkurën nga grupi punues,
- Projektligji për Ndërtesat në bashkëpronësi do të shqyrtohet nga GP të martën më 6 nëntor 2012 në orën 11,00.
- Për Projektligjin për Pyjet, Komisioni konstatoi se nuk është e gatshme për procedimin në leximin e parë.

Mbledhja përfundoi në orën 12,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani